

Tirane, me 23 Janar 2019

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI I SHOQERISE

ALMATI shpk

Kreu 1

Neni 1 - Krijimi

Sot, me **23/01/2019**, une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **ALMATI shpk**.

Themeluesi i shoqerise eshte:

Matilda Shaban Matoshi lindur ne Tropoje date **13.10.1981** dhe banuese ne Tirane Njesia nr.11, Rruga Don Bosko, Nr 7 identifikuar me numer **ID 025327479** dhe numer personal **I16013046B**

“Ligji” eshte Ligji Nr. **9901**, dt. **14.04.2008** “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare” i ndryshuar; "Per Qendren Kombetare te Regjistriinit", dhe cdo legjislacion tjeter qe lidhet me kete, hartohet ky akt themelimi dhe statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **ALMATI shpk**,

Shoqeria ALMATI shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2 - Personaliteti juridik

Shoqeria ALMATI shpk, eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetem.

Kontributi i ortakut perben kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Ortaku gezon kuoten e tij ne shoqeri.

Neni 3 - Selia

Selia e shoqerise: Rr. "Dervish Hima", Ndertesa Ambasador 3, Kati 10, Zyra nr. 77/1,

Njesia Administrative Nr. 2 , Tirane, Shqiperi

Adresa Elektronike: almati.shpk@gmail.com

Selia e aktivitetit te shoqerise: Rruga "Dervish Hima", Ndertesa Ambasador 3, Kati 10,

Zyra nr. 77/1, Njesia Administrative Nr. 2 , Tirane, Shqiperi

Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte (nese ka): -

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon (nese ka):

Shoqeria mund te ndryshoje seline, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut.

Neni 4 - Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje aktivitet privat ne fushen e:

Ofrimit te sherbimeve te ndermjetesimit te marreveshjeve mes shoqerive Tregtare (shqiptare dhe te huaja), ndermjetesimin e shoqerive tregtare ne marredheniet kontraktore mes tyre; asistencë ne marredhenie me institucionë financiare private dhe shteterore. Pjesemarrje me kuota/aksione ne shoqeri tregtare, kryerja e investimeve ne shoqeri shqiptare dhe te huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqerive dhe asistencë ne veprimtarine e tyre, kryerja e cdo aktiviteti te lejuar nga legjislacioni per shoqerite tregtare. Perkthime, perqatitje dokumentacioni per marrjen e lejeve te ndryshme nga autoritete te ndryshme, shteterore apo private. Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fusha te ndryshme, si edhe perqatitja dhe menaxhimi i studimeve dhe projekteve te ndryshme. Tregetimi i mallrave te ndryshem; tregtimi dhe furnizimi i energjisë elektrike dhe te gazit natyror. Çdo veprimtari tjeter qe lejon legjislacioni Shqiptar dhe te huaj ne fuqi.

Neni 5 - Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore pa afat.

KREU II KAPITALI

Neni 6 - Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 LEKE.

Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht nga "ortaku" i shoqerise:

④ **Matilda Matoshi** zoterues i 1 kuote (100% te kuotave), me vlore te per gjithshme **100.000** (njeqind mijë) Leke, te cilat perfaqesojne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (makineri, pajisje, pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise,

Neni 7 - Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet sipas procedurave nepermjet nenshkrimive perkatese per pjesen e kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses me vendimin e asamblese se ortakeve.

Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 8 - Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise
- 9) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie apo dhurimi.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 - Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme Ortakeve vendos per ceshtje si:

- Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise (kuorum 50+1 te kuotave);
- Emerimin dhe shkarkimin e administrator-it-eve (kuorum 60+1 te kuotave);
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar (kuorum 60+1 te kuotave); Percaktimin e shperblimeve (kuorum 50+1 te kuotave)

d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator-i-et, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; (kuorum 50+1 te kuotave)

- perfaqesimin e shoquerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; (me perfaqesues te zgjedhur me kuorum 50+1 te kuotave)

- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese (kuorum 50+1 te pranishme);

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise (kuorum 60+1 te kuotave);

- shperndarjen e fitimeve vjetore dhe inbulimin e humbjeve (kuorum 50+1 te kuotave);

- investime (unanini);

9) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoquerise (unanim);

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 10 - Administrimi

Administrator i shoquerise eshte znj. Matilda Matoshi.

Administratori i shoquerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjear me te drejte riperteritje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administrator i shoquerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11 - Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te;

a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoquerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve;

- Perfaqesoje shoquerine tregtare;
 - c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoquerise;
 - ç) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise si dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
 - d) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoquerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoquerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit :
- raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoquerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve edhe ne rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoquerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te tij, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoquerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoquerise, ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoquerise.

Neni 12 - Pergjegjesite

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoquerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoquerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve qe i sjellin dem shoquerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, administratori detyrohet:

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemandje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid;
 - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - c) te vleresoje me per gjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim
 - ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personate me ata te shoqerise;
 - d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
-
2. Administrator-i-et, gjate kryerjes se detyrave te tij / tyre, per gjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
 3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personal e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e si pas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
 4. Ne menyre te vecante por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e me poshtme:
 - a) u kthen ortakeve kontributet;
 - b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
 - c) u shpemdan aktivet shoqerise;
 - d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.

Neni 13 - Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, vtit te pare financiar, i cili fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 14 - Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vtit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vtit te meparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 - Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese dhe dorezoje ne kohe ortak-ut / -eve per ti shqyrtuar dhe miratuar mbi bazen e te drejtes vendimarrese qe ka.

Neni 16 -

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondevi ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, ndahan ne perpjestim me kuotat qe kane ortaket.

Neni 17 - Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e tij;
- me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shnuar ne cdo dokument te nxerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, pervepse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posacme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit.

Likuiduesi i nenshtrohet mbikeqyrjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe Administratorit.

Neni 19 - Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar

3.Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit verejne se pasuria e shoquerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit, nje bilanc te gjendjes se shoquerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedure e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit gjithashtu pasqyrat fmanciare vjetore te shoquerise. Bilancet miratohen nga asambleja e pergjithshme e ortakeve.

Neni 20 - Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetur, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon ç'regjistrimin e shoquerise. Ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 21 - Bashkimi

Shoqeria mund te bashkohet me nje ose me shume shoqeri nepermjet;

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqerive, që quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqeri tjeter ekzistuese e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, që bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoquerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim te nje shoqerie te re.

Neni 22 - Ndara

1. Shoqeria mund te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria që ndahet vleresohet e prishur.

2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008".

3. Shoquerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqueri pritese dhe per gjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje: kalimin te shoquerite pritese te te gjithe aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;

Berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume shoqerive pritese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes; vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas sektionit V, te ligjt nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likujdimit.

Neni 23 - Shnderrimi

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare. Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve,

Neni 24 - Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 25 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare,

Neni 26 Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua nga "Ortaku i Vetem i kesaj shoqerie" ne 5 kopje me vlere te njejtë juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM

Matilda Matoshi

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Matilda Matoshi".